



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1589 Prot.

Tiranë, më datë 28.12.2023

VENDIM
Nr. 613, datë 28.12.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.12.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të Projekt idesë për “Projektimin, restaurimin dhe muzealizimin e ish banesës së Toptanasve/ Libohovitët, “Muzeu Besa”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me vendndodhje Bashkia Tiranë, me aplikues z. Jurtin Hajro dhe **zhvillues Ministria e Kulturës**;
2. Projekti të marrë në konsideratë rekomandimet e anëtarëve në mbledhjen e KKTKM-së;
3. Të realizohen sondazhe arkeologjike nga subjekt i licencuar në arkeologji, të cilat duhet të depozitohen pranë IKTK, proces i cili do të mbikëqyret sipas Ligjit Nr. 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nga DRTK Tiranë;
4. Rezultatet e sondazheve arkeologjike të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

KRYETAR
Elva MARGARITI

